

MUNËDSI PËR GRATË NDËRMARRËSE

Organizata Germin fton gratë ndërmarrëse në Kosovë, bizneset e të cilave kanë potencial për eksport që të përfitojnë nga programi i mentorshipit për një periudhë shtatë (7) mujore nga profesionistët/et e diasporës.

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Organizata Germin me përkrahje të ‘USAID Kosovo Compete Activity’ është duke implementuar projektin **“Diaspora për gratë ndërmarrëse”**. Qëllimi kryesor i projektit është të lehtësojë lidhjen e bizneseve në pronësi dhe/ose të menaxhuara nga gratë në Kosovë, me bizneset dhe profesionistët/et në diasporë, me qëllim të përshpejtimit të rritjes së bizneseve të udhëhequra nga gratë në Kosovë përmes mentorimit dhe rrjetëzimit me profesionistë/e të Diasporës. Një nga problemet kryesore që ndërhyrja synon të adresojë është rritja e kufizuar e bizneseve në pronësi të grave në Kosovë për shkak të mungesës së qasjes në tregjet e huaja, veçanërisht të bizneseve me kapacitete për eksport.

Objektivat e projektit

Përveç qëllimit kryesor të projektit, Germin në bashkëpunim të ngushtë me USAID Kosovo Compete Activity në Kosovë kanë hartuar tri objektiva kryesore, të cilat janë si në vijim:

1. Ngritje e kapaciteteve të grave ndërmarrëse në menaxhimin e biznesit, diversitetin financiar, rrjetëzimin, brendimin, etj;
2. Rritjen e qasjes së bizneseve në pronësi të grave nga Kosova në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare si dhe përmirësimi i pranisë/aktivitetit digjital të grave ndërmarrëse kosovare;
3. Përshpejtimi i rritjes së bizneseve në pronësi të grave në Kosovë përmes rritjes së mundësive të punësimit në afat të mesëm ose afatgjatë përmes pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e granteve që synojnë të rrisin shkallën e tyre të eksportit dhe qasjen në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

Programi i mentorshipit

Germin do të përzgjedhë 10 profesionistë/e nga Diaspora të cilët për një periudhë shtatë (7) mujore do të angazhohen si mentorë/e për 45 gra ndërmarrëse në Kosovë, me synimin që këto të fundit të ngritin njohuritë nga përvoja e homologeve të tyre në diasporë si dhe të identifikojnë mangësitë eventuale që i kanë në bizneset e tyre. Sektorët e preferuar të bizneseve të grave ndërmarrëse nga Kosova për t’u bërë pjesë e këtij programi janë **Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK); Prodhimi apo përpunimi i Ushqimit; Përpunimi i Drurit**. Por, nuk përjashtohen sektorë të tjerë me potencial për eksport.

Detajet specifike programit të mentorshipit

Kohëzgjatja e projektit si tërësi është 18 muaj, ndërsa periudha e mentorshipit në fazën e parë do të zgjasë 7 muaj gjatë vitit 2022. Secili/a mentor/e nga Diaspora do të ketë në mentorim nga 3 deri në 5 gra ndërmarrëse nga Kosova. Gjatë periudhës shtatë mujore do të mbahen 7 sesione online. Të gjithë procesin gjatë periudhës shtatë mujore do ta fasilitojë Germin, ku përveç koordinimit të vazhdueshëm do të sigurohet që të promovoj komponentën e mentorshipit me qëllim të rrjetëzimit sa më të madh të grave ndërmarrëse me hisedarë për rritje të biznesit dhe qasje në tregun rajonal dhe ndërkombëtar.

Përfitimet kryesore për gratë ndërmarrëse nga programi i mentorshipit

Gjatë periudhës së mentorshipit gratë ndërmarrëse në Kosovë ndër të tjerat mund do të përfitojnë njohuri shtesë rreth:

- Teknikave të menaxhimit më të mirë të biznesit;
- Menaxhimit financiar më stabil;
- Metodave të rritjes së burimeve financiare dhe njerëzore;
- Qasjes në tregjet e huaja jashtë Kosovës – fillimi i eksportit të produkteve;
- Përgatitjes dhe organizimit të takimeve Biznesi me Biznesin (B2B) dhe Biznesi me Klientin (B2C);
- Procedurat e monitorimit dhe vlerësimit të punës së biznesit;
- Rrjetëzimit me kompani të tjera të profilit të ngjashëm brenda dhe jashtë Kosovës;
- Brendimi dhe ambalizimi i produkteve apo shërbimeve;
- Prezenca dixhitale dhe përdorimi i mediave sociale, etj.

Përgjegjësitë e grave ndërmarrëse përfituese të programit të mentorshipit

Padyshim që programi i mentorshipit për gratë ndërmarrëse do të shërbej në përfitim të njohurive të reja, ide për rritje të biznesit, stabilitet, rritje të resurseve humane si dhe fillim/rritje të eksportit. Gjatë periudhës shtatë mujore sa do të zgjas programi i mentorshipit grat ndërmarrëse duhet të jenë aktive në pikat në vijim:

- Të tregojnë se janë të gatshëm për bashkëpunim dhe kanë interes të përfitojnë nga programi i mentorshipit
- Të jenë pjesë e çdo sesi online
- Të mbajnë takime të vazhdueshme me hisedarë për mundësitë e rrjetëzimit dhe fillimit të eksportit për produktet e tyre.
- Të promovojnë në rrjete sociale dhe emisione televizive përvojën e mentorshipit dhe sukseset që do të kenë gjatë periudhës shtatë mujore në biznesin e tyre.

Si të bëheni pjesë e programit të mentorshipit

Të gjitha gratë ndërmarrëse të cilat kanë interes të përfitojnë nga programi shtatë mujor i mentorshipit duhet të përmbushin kriteret në vijim:

- Të jenë të regjistruara në ATK
- Të posedojnë numër fiskal
- Të mos kenë borxhe në ATK
- Të jenë biznese me potencial për eksport

Për të aplikuar, klikoni [KËTU](#)